



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Dhjetor 2022

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Dhjetor 2022

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin dhjetor të vitit 2022)**

### Prokuroritë rifillojnë punën me kapacitete të plota

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka marrë vendim për anulimin e pjeshëm të vendimit Nr.1458/2022 (pika I dhe IV mbetën në fuqi) dhe nga dita e hënë, 5 dhjetor 2022, të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës do të rifillojnë punën me kapacitete të plota.



Pezullimi i bashkëpunimit për iniciativat e përbashkëta në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës do të vazhdojë deri në një vendim tjetër, ndërsa KPK dhe prokuroritë do të marrin pjesë në komisionet dhe grupet tjera ku pjesëmarrja përcaktohet me legjislacionin në fuqi. Ky vendim i KPK-së vjen pas Aktvendimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës e cila ka aprovuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë lidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për uljen e pagave të prokurorëve.

### Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Komisioni për Administrimin e Prokurorive diskutoi për mënyrën e regjistrimit të rasteve të nxitjes së urrejtjes dhe LGBTI dhe për hapat që duhet të ndërmerren për të siguruar se raportimi i statistikave është i saktë dhe i avancuar. U tha se me funksionalizimin e plotë të SMIL-it, kjo çështje lidhur me këto vepra penale si dhe veprat tjera do të rregullohet në tërësi.



U diskutua edhe për Raportin me rekomandime për përmirësimin e mbledhjes dhe analizës së statistikave për të monitoruar punën dhe performancën e prokurorive”, i hartur bazuar me metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) nga projekti “Forcimi i Cilësisë dhe Efikasitetit të Drejtësisë - Projekti KoSEJ II i Këshillit të Evropës.

### Komisioni për Çështje Normative finalizon draftin e Rregullores për Rekrutimin dhe Përzgjedhjen e Bashkëpunëtorëve Profesionalë

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga prokurori Armend Zenelaj shqyrtoi edhe një herë nen për nen draftin e Rregullores për Rekrutimin dhe Përzgjedhjen e Bashkëpunëtorëve Profesionalë në sistemin prokurorial, draft ky, i përgatitur po nga ky komision gjatë takimeve të mëhershme.



Drafttregullorja parasheh mënyrën, kriteret dhe procedurën e rekrutimit të bashkëpunëtorëve profesionalë në sistemin prokurorial, ndërsa ka për qëllim të realizohet një procedurë me efikase dhe më profesionale për rekrutimin e tyre.

### Prokuroria Themelore e Gjilanit me statistika të mira në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, ka vazhduar vizitat nëpër prokurori, ku sot kanë vizituar Prokurorinë Themelore të Gjilanit, me ç’rast janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie.



Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme, që dalin në rrugën që ka përpara kjo prokurori.

Anëtarët e Komisionit, thanë se, sipas statistikave, në gjashtëmuorin e parë të këtij viti, Prokuroria Themelore e Gjilanit ka dalë prokuroria më e suksesshme në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike. Por, përkundër rezultateve të mira, u kërkua përkushtim i vazhdueshëm në trajtimin e këtyre lëndëve.

### Kërkohet përkushtim i vazhdueshëm në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Themelore të Prishtinës, me ç’rast janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie. U diskutua për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme, që dalin në rrugën që ka përpara kjo prokurori. Në këtë takim, anëtarët e Komisionit, përkundër rezultateve të arritura në trajtimin e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike në këtë prokurori, kërkuan një përkushtim më të madh dhe të vazhdueshëm në trajtimin e këtyre lëndëve.



Në fund të takimit anëtarët e Komisionit thanë se luftimi i korrupsionit duhet të jetë prioritet i punës nëpër prokurori.

### Krerët e KGJK-së dhe KPK-së pritën në takim Ambasadorin e Zyrës së Bashkimit Evropian

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Albert Zogaj dhe Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, kanë pritur në takim Ambasadorin e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE), z. Tomáš Szunyog, Menaxherin e Programit nga Zyra e BE-së, z. Nicola Scaramuzzo dhe zyrtarët për politika nga Zyra e BE-së, znj. Afërdita Smajli dhe z. Mats Persson.



Gjatë takimit është diskutuar vazhdimi i bashkëpunimit në mes të sistemit gjyqësor dhe prokurorial me Zyrën e Bashkimit Evropian, reformat në sistemin e drejtësisë me qëllim të avancimit të ligjit në Kosovë. Të dy kryesuesit, theksuan gatishmërinë e të dy këshillave për bashkëkoordinim dhe përmbushjen e aktiviteteve me Zyrën e BE-së, me qëllim të forcimit të sundimit të rendit nga ana tjetër, Ambasadori Szunyog dhe përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, konfirmuan mbështetjen për fuqizimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

### Memorandum bashkëpunimi në mbështetje të sundimit të ligjit në Kosovë

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe projekti "Iniciativa për Sundimin e Ligjit në Ballkanin Perëndimor - Krimi i

Rëndë dhe i Organizuar", i cili implementohet nga Chemonics International Inc dhe financohet nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, kanë nënshkruar Memorandum të Bashkëpunimit.




Memorandum i bashkëpunimit është nënshkruar nga Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku dhe Udhëheqësi i këtij projekti, Christopher Marshall. Palët nënshkruese kanë rënë dakord të nënshkruajnë këtë memorandum për të reflektuar synimin e tyre të ndërsjellë për bashkëpunim dhe koordinim në një përpjekje të përbashkët për të mbështetur sundimin e ligjit dhe ndërprerjen e rrjeteve të krimit të organizuar serioz në Kosovë dhe në tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo përfshin mbështetjen e operacioneve dhe administrimit të programit. Memorandumi ka për qëllim të krijojë një shteg komunikimi ndërmjet palëve në lidhje me operacionet teknike të programit, përkatësisht diskutimet për krijimin e programeve dhe partneritetet ndërmjet palëve në Kosovë.

### Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike viziton PSRK-në

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike vizitoi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, me ç'rast janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie. Gjatë këtij takimi u diskutua për lëndët e korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme, që dalin në rrugën që ka përpara kjo prokurori.

Anëtarët e Komisionit, pasi u informuan nga Kryeprokurori për punët që janë duke u realizuar në këtë prokurori sa i përket lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, thanë se duhet të vazhdohet puna me prioritet për trajtimin e këtyre lëndëve.





### Komisioni për Çështje Normative vizitoi Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative zhvilloi një vizitë në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.



Në këtë takim pune, i cili u realizua në kuadër të monitorimit të zbatimit të akteve nënligjore dhe me qëllim të përmbushjes së detyrave, u diskutua për aspektet e zbatimit të akteve nënligjore në fuqi dhe për aktet që janë në proces të hartimit, të diskutimit apo edhe të miratimit në Këshillin Prokurorial të Kosovës. Me këtë rast, u prezantua edhe Pyetëtori i hartuar për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve nënligjore, për të cilin u tha se do të lehtësojë procesin e punës së Komisionit dhe për përmbushjen e detyrave për mbikëqyrjen e zbatimit të akteve dhe hartimin e akteve nënligjore, të parapara me Strategjinë e KPK-së për vitin 2022-2024.

### Diskutohet Raporti financiar nëntëmujor i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës shqyrtoi Raportin financiar nëntëmujor të Këshillit Prokurorial të Kosovës.



Sipas rendit të ditës, Komisioni ka shqyrtuar dhe aprovuar Planin e prokurimit për vitin 2024 dhe Planin e punës së Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel për vitin 2024.

### Vlerësohet angazhimi për implementimin e SMIL-it

Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Udhëheqësin e Sekretariatit Ndërkombëtar në Administratën Gjyqësore të Norvegjisë, me të cilin ka biseduar për Sistemin e Menaxhimit Informativ të Lëndëve – SMIL.



Ai njoftoi mysafirin nga Norvegjia me punët dhe angazhimin e realizuar dhe atë që pritet të realizohet deri në implementimin e plotë të SMIL-it, duke e falënderuar Mbretërinë e Norvegjisë për ndihmën e dhënë për implementimin e këtij projekti. Në anën tjetër, z. Arnstad e ka vlerësuar punën dhe angazhimin e sistemit prokurorial të Kosovës në implementimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve. Të dy bashkëbiseduesit kanë shprehur gatishmërinë e institucioneve që përfaqësojnë për vazhdimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në fusha të interesit të përbashkët edhe në të ardhmen.

## Kryesuesi i KPK-së Maloku ka pritur në takim ambasadorin e OSBE-së në Kosovë, Davenport

Kryesuesi Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Ambasadorin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, me të cilin diskutoi për avancimin e komunikimit dhe bashkëpunimit mes KPK-së dhe OSBE-së, me qëllim të fuqizimit të kapaciteteve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial të Kosovës.



Kryesuesi, tha se OSBE-ja ka dhënë kontribut të vazhdueshëm në mbështetje të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit në ngritjen e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve specifike, përmes hulumtimit dhe monitorimit të rasteve të dhunës në familje, hartimit të raporteve monitoruese dhe hartimit të Strategjisë kundër trafikimit të njerëzve. Në anën tjetër, edhe Ambasadori, tha se misioni i OSBE-së në Kosovë do të vazhdojë mbështetjen për sistemin prokurorial të Kosovës në të gjitha fushat e interesit të përbashkët. Gjatë këtij takimi, ambasadori Davenport u interesua edhe për situatën e krijuar në Prokurorinë Themelore të Mitrovicës pas dorëheqjes së ofruar nga prokurorët e komunitetit serb të kësaj prokurorie, ku nga Kryesuesi Maloku u njoftua me veprimet që janë marrë dhe janë duke u marrë lidhur me situatën e re të krijuar në këtë prokurori.

## Mbahet takimi i 224-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbajti Takimin e 224-të, në të cilin u miratua kërkesa e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren për avancimin e përhershëm të një prokurori në Departamentin e Krimeve të Rënda, me ç'rast, Këshilli ka marrë vendim për shpalljen e brendshme sipas kërkesës së lartcekur. KPK mori vendim për shfuqizimin e Vendimit të datës 21 tetor 2022, për reduktimin esencial të aktiviteteve të punës në Objektivin C të Pallatit të Drejtësisë, aty ku janë të vendosura Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria

Themelore e Prishtinës dhe nga nesër e mërkurë, 21 dhjetor 2022, puna në këto dy prokurori do të fillojë me kapacitete të plota.



Këshilli miratoi pjesërisht edhe Raportin për vlerësimin e performancës së shtatë prokurorëve me mandat të përhershëm, duke miratuar kështu edhe një kundërshtim të paraqitur kundër këtij raporti.

## Mbahet takimi i 225-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës themeloi Panelin hetimor për rastin disiplinor ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore në Prishtinë.



Në takim u miratuan edhe dy drafttregullore, ajo për Praktikantë në Sistemin Prokurorial, kurse e dyta për Procedurat e Rekrutimit, Përzgjedhjes së Bashkëpunëtorëve Profesionalë. Anëtarët e KPK-së miratuan edhe kërkesën e Ushtresit të Detyrës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë për transferimin e përkohshëm të një prokurori në Departamentin e Përgjithshëm, me ç'rast u mor vendim që prokurori i Departamentit të Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prizren, Ramadan Koro, të transferohet përkohësisht në departamentin e njëjtë të Prokurorisë Themelore në Gjakovë. KPK-ja miratoi dy edhe raporte për vlerësimin e performancës së prokurorëve, njërin për 10 prokurorë me mandat të përhershëm dhe tjetrin për tetë (8) prokurorë po ashtu

me mandat të përhershëm. Këshilli vendosi që t'i drejtohet Presidentes së Republikës së Kosovës që të japë një sqarim deri më 13 janar 2023 lidhur me rastin e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, Kastriot Memaj.

## Reagim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës është thellësisht i shqetësuar me deklaratat e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Albin Kurti dhe vartësve të tij, lidhur me vendimin ligjor për ndërrimin e masës së të pandehurit Dejan Pantiq nga paraburgimi në arrest shtëpiak, që është marrë pas kërkesë së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.



KPK vlerëson që reagimet e tilla të Kryeministrit Kurti dhe vartësve të tij janë tendencë për ndërhyrje në punët dhe pavarësinë e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës

Po ashtu, KPK shpreh indignatën e thellë me kërkesën e Kryeministrit Kurti për t'u informuar me emrin e prokurorit i cili ka bërë kërkesë për ndërrimin e masës ndaj të pandehurit Pantiq, nga se kjo përveç që ndikon në punën e pavarur të prokurorit, mund të nxitë edhe reagime që do mund të rrezikojnë jetën e tij.

Këshilli Prokurorial i Kosovës mbështet të gjitha vendimet e prokurorëve që janë të mbështetura në ligj, dhe ju bënë thirrje për të vazhduar punën e tyre të pavarur, profesionalisht dhe të mos ndikohen nga asnjë lloj ndërhyrjeje apo presioni.

Ndërsa, Kryeministrit Kurti dhe vartësve të tij, KPK ju bënë thirrje të respektojnë punën e institucionit të pavarur të Prokurorit të Shtetit, ngase tentativat për ndërhyrje, do të mbesin vetëm si të tilla.

## Kryesuesi Maloku prezantoi punën njëvjeçare të KPK-së

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Jetish Maloku, në konferencën e fundvitit për media, të mbajtur më 29 dhjetor 2022, ka prezantuar veprimtarinë njëvjeçare (2022) të Këshillit Prokurorial

të Kosovës, rezultatet dhe sfidat me të cilat Këshilli është ballafaquar në realizim të mandatit të tij, si dhe planifikimin për vitin 2023.



Kryesuesi Maloku me këtë rast, ka thënë:

*“Këshilli, këtë vit, ka mbajtur 18 takime dhe ka nxjerrë më shumë se 180 vendime, të cilat kanë shërbyer për realizimin e mandatit të tij ligjor dhe në shërbim të sistemit prokurorial. Për më tepër, Këshilli ka realizuar edhe takime të tjera të shumta përmes komisioneve të veta të përhershme, ad hoc dhe trupave të tjerë.*

*Më lejoni që të përmend disa nga sukseset dhe punët kryesore të realizuara nga Këshilli, bazuar në mandatin e tij kushtetues dhe ligjor:*

*Me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë, KPK gjatë kësaj periudhe ka hartuar dhe miratuar Planin strategjik të sistemit prokurorial 2022-2024. Ky plan paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës në tre vjetët e ardhshëm.*

*Këshilli, gjatë vitit 2022, ka hartuar dhe miratuar 5 rregullore, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e lëndëve përmes sistemit elektronik, zgjedhjen dhe përfundimin e mandatit të Drejtorit të Sekretariatit dhe atij të Njësitit, rekrutimin, provimin, emërimin dhe rrimërimin e prokurorëve të shtetit, përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe praktikantëve.*

*Për më tepër, Komisioni për Çështje Normative ka filluar aktivitetet e veta nëpër prokuroritë e Kosovës për të vlerësuar zbatueshmërinë e akteve nënligjore në fuqi.*

*Këshilli është në proces të riorganizimit të administratës së sistemit prokurorial, me qëllim të ngritjes së profesionalizmit dhe efikasitetit në punë.*

*Gjatë periudhës raportuese, Këshilli ka zhvilluar të gjitha procedurat për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kandidatit më të suksesshëm e ka propozuar për dekretim te Presidentja e Republikës së Kosovës. Lidhur me këtë proces, Këshilli ka publikuar konceptdokumentet*



e të gjithë kandidatëve, kurse intervistat janë zhvilluar në prani të përfaqësuesve të OJQ-ve dhe partnerëve ndërkombëtarë, si dhe janë transmetuar në mediumin publik - Radiotelevizionin e Kosovës (RTK), i cili mundësoi që secili qytetar të përcjellë këtë ngjarje të rëndësishme në sistemin e drejtësisë.

Kryeprokurorët e të gjitha prokurorive në baza tremujore kanë raportuar në Këshill.

Këshilli ka zgjedhur anëtarin e ri nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit, pasi që anëtarës aktuale i skadon mandati më 31 dhjetor 2022.

Në muajin prill 2022, Këshilli ka rekrutuar shtatë prokurorë të rinj dhe të njëjtit janë dekretuar nga Presidentja dhe kanë filluar punën në prokuroritë përkatëse.

Po ashtu, në muajin qershor 2022, Këshilli ka hapur konkursin tjetër për rekrutimin e 22 prokurorëve të rinj dhe deri më tani janë mbajtur dy testet dhe intervista, ndërsa është shpallur lista me emrat e 22 kandidatëve me të suksesshëm të këtij procesi dhe pas miratimit nga Këshilli, këta 22 emra do të dërgohen për dekretim të Presidentja.

Këshilli, përmes rrugëve ligjore, ka avancuar tre prokurorë dhe transferuar tetë të tjerë nëpër prokuroritë e Kosovës, ndërsa në punë janë edhe dy procese për avancim për katër prokurorë.

Një prej objektivave të Këshillit për këtë vit ka qenë llogaridhënia, profesionalizmi dhe disiplinimi i prokurorëve.

Andaj, gjatë vitit 2022, KPK ka pranuar nëntë kërkesa për fillim të procedurave disiplinore ndaj prokurorëve dhe ka themeluar tetë panele hetimore, ndërsa një kërkesë për inicim të procedurës është refuzuar nga Këshilli. Gjatë kësaj periudhe, ka shqiptuar masa disiplinore si në vijim, duke përfshirë edhe vendimet për rastet e vitit 2021, të cilat janë bartur në 2022:

4 vërejtje jopublike me shkrim, prej të cilave 3 me marrëveshje;

4 vërejtje publike me shkrim, prej te cilave 2 me marrëveshje;

3 vendime për transferimin e përhershëm në prokuroritë e tjera ku njëri është ndryshuar nga Gjykata Supreme në ulje të pagës për 50% për 6 muaj;

4 vendime ku prokurorët janë liruar nga përgjegjësia, në njërin është dërguar prokurori në Komision për Vlerësim të Performancës;

1 rast është pezulluar deri në përfundim të procedurës penale dhe

për 1 rast tjetër është themeluar paneli hetimor dhe është në proces të shqyrtimit të rastit.

Të gjitha vendimet e formës përfundimtare janë duke u publikuar në uebportalin e sistemit prokurorial të Kosovës, përveç vërejtjes jopublike me shkrim, siç parashihet me ligj.

Përmes Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve, Këshilli, gjatë vitit 2022, ka finalizuar vlerësimin e performancës për 61 prokurorë, të cilët janë vlerësuar si në vijim:

0 në nivelin Dalluar;

28 në nivelin Mirë;

32 në nivelin Mjaftueshëm;

1 në nivelin Pamjaftueshëm.

Grupit Monitorues për Mbikëqyrjen e Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike ka vazhduar me sukses punën edhe gjatë këtij viti, duke realizuar disa herë vizita nëpër të gjitha prokuroritë e Kosovës dhe ka hartuar raporte me rekomandime bazuar në të gjeturat, të cilat janë trajtuar në takimet e Këshillit.

Si rezultat, sistemi prokurorial ka arritur që gjatë periudhës nëntë mujore të këtij viti, nga 380 raste të korrupsionit të pranuar ka zgjidhur 272 raste, respektivisht, ka zgjidhur 72% të rasteve të pranuar.

Ndërsa, sa i përket krimeve ekonomike, nga 303 raste të pranuar janë zgjidhur 224 raste, respektivisht janë zgjidhur 74% e rasteve të pranuar.

Pra, raportet aktuale tregojnë për një efikasitet në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike.

Në fushën e teknologjisë informative kemi filluar fazën tranzitore të projektit TIK/SMIL në bashkëpunim me Këshillin Gjyqësor për periudhën trevjeçare.

SMIL-i është duke u zbatuar me sukses në të gjitha prokuroritë themelore, në Prokurorinë Speciale dhe në Prokurorinë e Apelit, duke përfshirë edhe shpërndarjen automatike të lëndëve te prokurorët. Ndërsa, SMIL-i është zhvilluar për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe jemi në fazën e trajnimit të stafit administrativ për përdorimin e tij.

Për më tepër, është avancuar ndërlidhja në mes të prokurorisë dhe gjykatës, përkatësisht, pjesa e ankimit, duke mundësuar që dokumentet të dërgohen në mënyrë elektronike.

Në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës është përgatitur dhe nënshkruar Procedura Standarde e Veprimit të Shkëmbimit Elektronik të të Dhënave në mes



të Prokurorisë dhe ATK dhe është nënshkruar marrëveshje në mes të Këshillit dhe Doganës për ndërlidhjen e sistemeve dhe shkëmbimin elektronik të të dhënave.

Buxheti i Këshillit për vitin 2022 pas rishikimeve buxhetore ishte 12,477,991.72 euro.

Deri më tani, Këshilli Prokurorial i Kosovës ka realizuar 92.1% të buxhetit total, për të gjitha kategoritë ekonomike dhe programet buxhetore të Këshillit për shpenzimet e krijuara deri më 29 dhjetor 2022.

Buxheti i Këshillit, i miratuar për vitin 2023, është 15,913,983.00€, por as për këtë vit nuk është miratuar plotësisht sipas kërkesave dhe nevojave tona.

Këshilli ka pranuar edhe Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit, sipas të cilit nuk ka pasur asnjë të gjetur të kualifikuar.

Këshilli ka vazhduar politikën e bashkëpunimit të hapur dhe profesional me të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare, me donatorë dhe partnerë të shumtë, të cilët dua t'i falënderoj edhe përmes kësaj konference për mbështetjen e madhe dhe të vazhdueshme që po japin për Këshillin Prokurorial.



Kryesuesi i Këshillit gjatë vitit 2022, me autorizim të Këshillit, ka nënshkruar 8 marrëveshje bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të realizimit të mandatit të vet, me theks të veçantë në ngritjen e bashkëpunimit dhe ngritjen e efikasitetit në luftë kundër shkelësve të ligjit.

Sistemi prokurorial ka vazhduar publikimin e Raportit 24 orësh, përmes së cilit publiku njoftohet lidhur me veprimet e prokurorive për 24 orë.

Në të gjithë sistemin prokurorial janë caktuar zyrtarët për sinjalizim.

Uebportali i sistemit prokurorial është pasuruar në baza ditore me informata të reja që mund t'u shërbejnë qytetarëve.

Këshilli, përmes Zyrës për Komunikim, në baza ditore iu ka përgjigjur interesimit të mediave dhe shoqërisë civile. Po ashtu, në baza ditore ka bërë publike aktivitetet dhe punët përmes komunikatave që janë publikuar në uebfaqen zyrtare.

Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk do të ndalet së punuari që komunikimi, transparenca, llogaridhënia, perceptimi dhe besueshmëria për këtë sistem të arrijnë vlerësimin e merituar nga opinioni publik.

Këshilli në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit ka arritur që edhe gjatë vitit 2022 të koordinojë dhe mbështesë ngritjen e kapaciteteve të prokurorëve dhe stafit. Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë dhe partnerë të tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë janë organizuar programe të ndryshme trajnuese, bazuar në nevojat e sistemit prokurorial.

#### Sfidat gjatë vitit 2022

Gjatë veprimtarisë sonë për vitin 2022 përveç të arriturave natyrisht që kishim edhe sfida të ndryshme. Dëshiroj të theksoj se ndër sfidat kryesore me të cilat jemi ballafaquar janë:

Mosplotësimi i përbërjes së Këshillit me dy (2) anëtarë joprokurorë, që me hyrjen në fuqi të Ligjit për Këshillin Prokurorial në prill vitit 2019, nuk është përgjegjësi e Këshillit as përzgjedhja dhe as procedurat teknike të shpalljes së konkursit;

Buxheti i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha obligimet e krijuara;

Vonesa në dekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit;

Kushtet e vështira në Pallatin e Drejtësisë;

Ndërmarrja e aktiviteteve të shumta për mbrojtjen e pavarësisë së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit;

Vendimi i Qeverisë për uljen e pagave të prokurorëve;

Specializimi i prokurorëve për trajtimin e krimeve karakteristike (korrupsioni, krimi i organizuar, krimi ekonomik dhe krimet kibernetike);

Mosrespektimi i parimit të transparencës përmes disa publikimeve mediale që ndikojnë drejtpërdrejt në dëmtimin e besimit të publikut në sistemin prokurorial;

Infrastruktura fizike (zgjerimi i hapësirave për Këshillin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit) dhe

Ngritja e kapaciteteve profesionale të personelit të sistemit prokurorial.

Ne si Këshill kemi trajtuar seriozisht këto sfida, duke dërguar kërkesa të shumta dhe të argumentuara buxhetore në Ministrinë e Financave, në Qeveri dhe në

Kuvend, të cilat vazhdojnë të mostrajtohen nga ana e tyre.

#### Planifikimi i punës së Këshillit për vitin 2023

Këshilli do të vazhdojë punën në aktet nënligjore për riorganizimin e administratës dhe strukturës organizative.

Për më tepër, në reflektim të ndryshimeve ligjore, Këshilli do të vazhdojë punën në hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore përkatëse të parapara me këto ndryshime.

Gjatë vitit 2023 pritet të finalizohet procesi i rekrutimit të 22 prokurorëve të rinj.

Do të zhvillohen procedurat për zgjedhjen e kryeprokurorëve të Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore të Prishtinës, duke qenë se mandati i tyre skadon në fund të vitit 2023.

Si përfundim, ju njoftoj se në pajtim me ligjin, Këshilli do të publikojë Raportin e punës për vitin 2022 në fillim të vitit 2023 dhe do ta bëjë të qasshëm në faqen zyrtare të Këshillit dhe në kopje fizike, me ç'rast publiku dhe Ju, përfaqësues të nderuar të mediave, do të informoheni në detaje për aktivitetet tona gjatë vitit që po e lëmë pas.

Me këtë rast, ju falënderoj juve si përfaqësues të mediave të respektuara për bashkëpunimin që kishim gjatë këtij viti dhe ju uroj Vitin e Ri 2023, duke shprehur edhe njëherë gatishmërinë e Këshillit dhe përgjithësisht të sistemit prokurorial për avancimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në të ardhmen.”

#### Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariati i KPK-së, gjatë muajit dhjetor, ka mbajtur takim me ekspertët e CEPEJ-it, me ç'rast është diskutuar raporti i rekomandimeve për përmirësimin e mbledhjes dhe analizës së statistikave për të monitoruar punën dhe performancën e prokurorive.

Në aspektin e ngritjes së kapaciteteve profesionale janë mbajtur trajnime dhe punëtori, si në vijim: për regjistrimin fizik (sekuestrimin/konfiskimin/ngrirjen e pasurive të fituara me vepër penale) në SMIL dhe dizajnimin e raporteve statistikore; si dhe identifikimin e nevojave dhe hartimin e kurikules trajnuese” dhe seminari për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm me zyrtarët për komunikim të prokurorive të vendit, në bashkorganizim me IRZ-në.

Në bashkëpunim me Agjencionin e Shoqërisë së Informacionit është duke e avancuar sistemin e sigurisë së informacionit përkatësisht aplikimi i masave mbrojtëse ndaj viruseve të mundshëm në rrjetet elektronike të sistemit prokurorial.

Nga ana tjetër, është përgatitur edhe projekti për zhvillimin dhe implementimin e sistemit elektronik e-libraria për sistemin prokurorial, i cili është dërguar në UNDP për mbështetje financiare.

#### Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHPP-ja, gjatë muajit dhjetor 2022, ka mbështetur Komisionin për Administrimin e Prokurorive në hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2023, kontrollimin dhe verifikimin e shënimeve statistikore të raporteve të SMIL-it lidhur me saktësinë dhe cilësinë e shënimeve statistikore, si dhe ka dhënë kontribut në takimet me kompaninë për zhvillimin e raporteve statistikore të SMIL-it dhe në takimin e Projektit KOSEJ.

Gjithashtu, NJSHPP-ja ka përgatitur raporte statistikore për prokuroritë e vendit dhe raportet për ngarkesën e prokurorëve me lëndë dhe efikasitetin në zgjidhjen e tyre, gjatë muajit nëntor, si dhe ka gjeneruar të dhënat nga aplikacionet e ndryshme.